



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:066487

Datë: 28.05.2019

Numri i dokumentit: 00333686

PKR.nr. 60/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE –Departamenti për Krime te Rënda, në Trup Gjykuese të përbërë prej Gjyqtarit Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykues, dhe Gjyqtarëve Myfera Hoxha dhe Nikollë Komani anëtarë të trupit Gjykues, me pjesëmarrjen procesmbajtëses Bute Ramosaj, në çështje penale kundër të akuzuarve G. M. Rogova, E. G. R., dhe E. G. R., te gjithë nga Gjakova, për shkak veprës penale lëndim i lehte trupore nga neni 188 prg 2 lidhur me prg 1 nen prg 1.4 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, dhe te akuzuarit E. G. R. nga Gjakova, për shkak te veprës penale lëndim i rëndë trupore nga neni 186 prg 3 lidhur me prg 1 te KPRK-se, dhe veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se, te akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore –Departamenti për Krime te Renda ne Gjakove, PP/I.nr.161/2013, te datë 07.11.2018, pas mbajtjes se seancën së shqyrtimit kryesor publik të mbajtur më datën 02.04.2019, 25.04.2019, dhe 16.05.2019, me pjesëmarrjen e Prokurorit te Shtetit te PTH në Gjakovë Ali Uka, të akuzuari G. R. dhe mbrojtësin e tij av. A. R. nga Gjakova, i caktuar sipas detyrës zyrtare, te akuzuarit E. R. dhe E. R., dhe Er. R. dhe mbrojtësit av. M. V., nga Gjakova, i caktuar sipas detyrës zyrtare, dhe te dëmtuarit D. R., muar dhe publikisht shpalli me dt. 21.05.2019, ndërsa me dt. 24.05.2019 përpiloi këtë :

AKTGJYKIM

1.I akuzuarit: G. R. nga i ati M. dhe ëma M. e gjinisë R. data e lindjes... ne Gjakovë, ku dhe jeton ne rrugën “ E. Gj.” nr. ... me numër personal ... i martuar i ati 3 fëmijëve, ka te kryer shkollën mesme, i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar Sh. I R. Kosovës, ka qene ne paraburgim nga dt. 02.09.2013, gjere me dt. 15.02.2014. dhe nga dt. 16.02.2014 gjer e me dt. 15.04.2014, ne arrest shtëpiak.

2.I akuzuarit: E. R.nga i ati G.dhe ëma M. e gjinisë Ij data e lindjes... ne Gjakovë, ku dhe jeton ne rrugën “ E. Gj. “ nr. ..., me numër personal i pa martuar ka te kryer shkollën e mesme i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar Sh. I R. Kosovës, ka qene ne paraburgim nga dt. 02.09.2013, gjere me dt. 12.11.2013

3.I akuzuarit: E. R. nga i ati G. dhe ëma M. e gjinisë I data e lindjes... ne Gjakovë, ku dhe jeton ne rrugën "E. Gj." nr. ..., me numër personal i pa martuar ka te kryer shkollën e mesme i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar Sh. I R. Kosovës, ka qene ne paraburgim nga dt. 02.09.2013, gjere me dt. 15.02.2014, dhe nga dt. 16.02.2014, gjere me dt. 15.04.2014 ne masën e Arrestit shtëpiak.

4.I akuzuarit: E. R. nga i ati G. dhe ëma Me. e gjinisë I. i lindur data e lindjes... ne Gjakovë, ku dhe jeton ne rrugën "E. Gj." nr. ..., me numër personal ... , i martuar i ati i dy fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme, i pa pune , i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar Sh. I R. Kosovës.

JANË FAJTOR

Të pandehurit G. E., dhe E. R., me d t. 01.09.2013, tjetrit i shkaktojnë lëndime t e lehta trupore me dënim te përkohshëm te shëndetit personit tjetër ne atë mënyrë q ë ditën kritike rreth orës 22:40 min, ne rrugën " U. " tek vendi ku lidhet me rrugën " E.Gj. " gjersa t e dëmtuarit N. Z., G.B., dhe D. R., ishin duke kaluar me automjetin e udhëtareve te llojit " ... " te cilin e drejtonte i dëmtuari N. aty i dalin përpara te pandehurit E. dhe Er. R. aty fillon një fjalosje e me pas rrahje aty ndërhyjnë disa persona te cilit ishin ne një dyqan ne afërsi te vendit te ngjarjes dhe me pas te pandehurit me shpejtësi largohen nga vendi i ngjarjes për tu kthyer pas 5 minutave dhe i pandehuri G.me një shkop bejsbolli gjersa te pandehurit E. dhe E. me grushte dhe shqelma i godasin te dëmtuarit N. dhe G. duke i shkakuar lëndime te lehta trupore dhe atë te dëmtuarit N. ndrydhje te njejve te buta te regjionit te qafës dhe regjionit te shpatullës se djathte te shoqëruar me gërvishtje si dhe te dëmtuarit G. B., ndrydhje te indeve te buta ijore dhe gërvishtje ne mbi vetullën e majtë, dhe ne para krahun e majtë, dëmtime te lehta trupore, me afër te përshkuar ne mendimin e ekspertit mjeko- ligjore dr. F. B. te dt. 07.07.2014.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupore nga neni 188 prg 2 lidhur me prg 1 nen prg 1.4 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-së.

Ne kuptim te nenit 363 prg 1 pika 1.1 te KPPK-se,

REFUZOHET AKUZA

Kundër te pandehurit G. R. se me dt. 01.09.2013, tjetrit i shkakton lëndim te rëndë trupore me mjete te rrezikshëm duke i shkakuar dëmtime te rëndë te shëndetit në a të mënyrë që ditën kritike rreth orës 22:40 min, ne rrugën " W... " tek vendi ku lidhet me rrugën " E. Gj. " ne Gjakove, gjersa te dëmtuarit N. Z., G. B. dhe D.R., ishin duke kaluar me automjetin e udhëtareve te llojit " .. " atyre ju dalin përpara te pandehurit E. dhe E. R. aty fillon një fjalosje dhe me pas rrahje aty ndërhyjnë disa persona te cilët ishin në dyqan ne afërsi te vendit te ngjarjes e pas 5 minuta i pandehuri G. me një shkop bejzbolli ashtu qe i pandehuri G. e godet te dëmtuarin D. me ate shkop te bejzbollit ne drejtim te këmbëve te dëmtuarit D. duke i shkakuar lëndim ne zogun e këmbës se djathtë dhe atë lëndim të rëndë trupor ashtu qe i dëmtuari menjëherë dërgohet për ne Spitalin Rajonale " Isa Grezda " ne Gjakove, për ofrimin e ndihmës mjekësore.

-këso dore kishte për te kryer vepër penale lëndim i rëndë trupore nga neni 189 prg 5 lidhur me prg 1 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se.

i pandehuri E. R.

II. Me dt. 01.09.2013, tjetrit i shkaktonte lëndime te renda trupore me armë zjarri duke i shkaktuar dëmtim te rende te shëndetit ne atë mënyrë qe ditën kritike rreth orës 22:40 min, ne rrugën “U.” tek vendi ku lidhet me rrugën “E.Gj.” ndërsa te dëmtuarit N. Zy. G. B.dhe D.R. ishin duke kaluar me automjetin e udhëtareve te llojit “ ... “ aty ju dalin përpara te pandehurit E. dhe E. R. aty fillon një fjalosje e me pas rrahje aty ndërhyjnë disa persona te cilët ishin ne dyqan ne afërsi te vendit te ngjarjes dhe pas 5 minutave i pandehuri E. me një pushke automatike AK- 47, kalibrit 7.62 mm x 39 mm, shtënë disa here ne drejtim te këmbëve te dëmtuarit D. R. dhe se me një rën prej te shtënave e qëllon ne zogun e këmbës së djathte duke i shkaktuar lëndim te rëndë trupore , lëndime te përshkruar me afër ne mendimin e ekspertit mjeko- ligjore dr. F. B. te dt. 07.07.2014, e te plotësuar ne plotësim ne akt ekspertimin mjeko- ligjore te dt. 02.04.2019.

-me çka ka kryer vepër penale lëndim i rende trupore nga neni 186 prg 3 lidhur me prg 1 te KPRK-se.

III. i pandehuri E..R. me pare ka siguruar e gjere me dt. 01.09.2013, pa autorizim ka mbajtur armë dhe municion dhe atë një pushke automatike AK- 47, me numër serik 11121171, kalibrit 7.32 x 39 mm, si dhe një karikator me një fishekë te te njëjtit kalibër te cilën armë i pandehuri e ka përdor ditën kritike mënyrën e përshkruar si ne dispozitivin II te këtij aktgjykimi, duke i shkaktuar lëndime te renda trupore te dëmtuarit D. R. nga Gjakova, e te cilën armë te njëjtën ditë e konfiskon policia ne shtëpinë e tij ne Gjakovë ne rrugën “ E.Gj. “ nr. ...

- Me çka ka kryer vepër penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose ne posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6, 17, 41, 43, 45, 62, prg 1, pika 2.7, 73, 80, 83 nenit 188 prg 2 lidhur me prg 1 nen prg 1.4 lidhur me nenin 31, nënti 186 prg 3 /1 te KPRK-së, dhe nenit 374 prg 1 te KPRK-se, dhe neneve 359 par. 2, 366, 450 te KPPK-se, te akuzuarit.

I G J Y K O N

Te pandehurin **G. R.** për vepër penale lëndimi i lehte trupore nga neni 188 prg 2 lidhur me prg 1 nen prg 1.4 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 7 (shtate) muaj e 13 (trembëdhjete) dite, ne te cilin dënim do te

llogaritet koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 02.09.2013, gjere me dt. 15.02.2014, dhe nga dt. 16.02.2014 gjere me dt. 15.04.2014, Masën e Arrestit shtëpiak.

Te pandehurin **E. R.** për vepër penale lëndimi i lehte trupore nga neni 188 prg 2 lidhur me prg 1 nen prg 1.4 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, ne te cilin dënim do te llogaritet koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 02.09.2013, gjere me dt. 12.11.2013,

Te pandehurin **E. R.** për vepër penale lëndimi i lehte trupore nga neni 188 prg 2 lidhur me prg 1 nen prg 1.4 lidhur me nenin 31 te KPRK-se, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 7 (shtate) muaj e 13 (trembëdhjete) dite, ne te cilin dënim do te llogaritet koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 02.09.2013, gjere me dt. 15.02.2014, dhe nga dt. 16.02.2014 gjere me dt. 15.04.2014, Masën e Arrestit shtëpiak.

Te pandehurin **E.R.** për vepër penale lëndimi i rende trupore nga neni 186 prg 3 lidhur me prg 1 te KPRK-se, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite.

Për vepër penale mbajtje ne pronësi, kontroll, ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 8 (tete) muajve.

Në baze te nënti 80 te KPRK-se, te pandehurit **E. R.** i shqiptohet

DENIMI UNIK ME BURGIM

Ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashte) muaj, i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit.

I dëmtuarit **D. R.**, **G. B.** dhe **N. Z.** udhëzohen ne kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

I shqiptohet dënimi plotësues i konfiskohet pushka automatike **AK-47** me numër serik . . kalibrit 7.62 dhe 1 karikator dhe 1 fishekë te te njëjtit kalibër.

I akuzuari obligohet qe te paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe a te ne emër te ekspertizave te ekspertit mjeko- ligjore shume prej 150 € ne mënyre solidare, ne emër te paushallit gjyqësore shumen me nga 100€, si dhe ne emër te Fondit për kompensimin e Krimit te Viktimave shumen me nga 50 (pese dhjet e) €, te gjitha këto ne afate prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakove, - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.nr.161/2013, datë 07.11.2018, kundër të akuzuarve **G. R.**, **E. R.** dhe **E. R.** për shkak te veprës penale lëndimi i lehte trupore nga neni 188 prg 2 lidhur me prg 1 nen prg

1.4 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, dhe te akuzuarve G. R. dhe E.R. për shkak veprës penale lëndimi i rende trupore nga neni 189 prg 5 lidhur me prg 1 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, dhe te akuzuarit E. R. për vepër penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se.

Ne shqyrtimin fillestar te akuzuarit janë deklaruar te pa fajshëm për vepra penale për te cilën akuzoheshin, dhe pas plotfuqishmërisë se aktvendimit – kërkesës për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale është caktuar shqyrtimi gjyqësor.

Ne shqyrtimin gjyqësor te mbajtur me dt. 11.03.2019, te akuzuarit janë deklaruar te pa fajshëm, andaj Gjykata ka zbatuar procedurën e provave.

Pas përfundimit te procedurës se provave dhe mbrojtjes se te akuzuarve, Përfaqësuesi i akuzës Prokurori i shtetit **Ali Uka** ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: Se heq dore nga ndjekja penale për te akuzuarin G. R. , dhe atë sa i përket veprës penale nga dispozitivi i II i aktakuzës dhe atë për vepër penale lëndimi i rende trupore nga neni 189 prg 5 lidhur me prg 1 te KPRK-se, meqenëse nga provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësore nuk është arritur qe te provohet fajësia e tij për ketë vepër penale, ashtu qe si rrjedhoje i saj ka bere ndryshimin dhe plotësimin e dispozitivit te akuzës. Ndërsa sa i përket te akuzuarve G., E. dhe E. R. dhe atë dispozitivit te I te akuzës dhe kualifikimit juridik te dhënë ne te, mbetet i njëjtë e po ashtu edhe për te akuzuarin E. R. sa i përket dispozitivit te III te akuzës dhe kualifikimit juridik.

Gjate këtij shqyrtimi gjyqësore verbalë- publik dhe atë nga raporti i oficerit policor A.D. me numër 2013- OP-1192, i dt. 02.09.2013, lista e armëve t e konfiskuara si dhe dëshmitë e përpiluar nga ana e njësitit te forenzikës me numër te njëjtë i dt. 01.09.2013, nga raporti i ekspertizës te ekspertit mjeko-ligjore dr. F. B., te dt. 07.07.2014, për te dëmtuarit D. R., N. Z. dhe G. B. , nga raporti i Spitalit regjionale “ I. G. “ne Gjakove, i dt. 01.09.2013, nga flete lëshimi me epikriz për te dëmtuarin D. R. , reparti ortopedik i Spitalit Regjionale “ Isa Grezda “ ne Gjakove, nga raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes i përpiluar nga Njësi i hetimeve ne Gjakovë, i dt. 01.09.2013, nga foto e vendit te ngjarjes dhe nga plotësimi i ekspertizës mjeko- ligjore për te dëmtuarin D. R. i përpiluar nga eksperti mjeko - ligjore dr. F. B. i dt. 02.04.2019, si dhe nga deklarimet - marrjes ne pyetje te dëshmitareve - te dëmtuarve D. R., G. B. dhe N.Z. , pa mëdyshje është arritur qe te provohet se ne veprimet e te akuzuarit E. R. qëndrojnë te gjitha elementet qenësore te veprës penale lëndimi i rende trupore nga neni 189 prg 5 lidhur me prg 1 te KPRK-se, si dhe elementet e veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armeve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se, ndërsa ne veprimet e te akuzuarve G. R., E. R., dhe E. R. formohen te gjitha elementet qenësore te veprës penale lëndimi i lehte trupore nga neni 188 prg 2 lidhur me prg 1 nen prg 1.4 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se.

Andaj deklaroi se mbetem ne tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik si dhe ndryshimit dhe plotësimeve te dhëna ne ketë fjalë përfundimtare ashtu qe i ka propozuar trupit Gjykuese qe te akuzuarit ti shpalli fajtor për vepër penale qe akuzohen sipas aktakuzës te gjykohen sipas Ligjit, te obligohen ne pagesën e shpenzimeve procedurale dhe ndaj te akuzuarit Ermal Rogova ti shqiptohet edhe dënimi plotësues ti konfiskohet arma si ne dispozitiv te akuzës.

I dëmtuari **D.R.** ka deklaruar se ndaj te akuzuarve i bashkëngjitet ndjekjes dhe ka parashtruar kërkesën pasurore juridike dhe këtë do te realizoi ne kontest te rregullt civil, ndërsa te dëmtuarit G. B. dhe N. Z. kane deklaruar se ndaj e akuzuarve nuk i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe nuk kane parashtruar kërkesë pasurore juridike pasi qe rastin ja u kane falë.

I akuzuari **G.R.** ne mbrojtje te vete te dhëne ne te gjitha fazat e procedurës ka deklaruar se natën kritike me dt. 01.09.2013, ka qene ne shtallë dhe pasi është kthyer nga atje ne shtëpi diku pas orës 23:00/h, ka ardhur me traktor e kam lenë traktorin brenda dhe duke e mbyllur derën e shtëpisë kane ardhur dy djemtë te lagjes dhe me kanë thënë se djem e mija janë duke bere fjale me do djemtë ne rrugë. Ka shkuar ne drejtim te vendit te ngjarjes dhe rrugës ka qene i prishur një mure dhe nga aty kame marrë një leftë te drurit kur kam shkuar ne vendin e ngjarjes e kam pare djalin tim qe ishte përgjakur dhe qëllimi im ishte qe ti marrë djemtë dhe ti qetësoi. Pasi qe këtu i dëmtuari N. me është afruar te njëjtën e kam goditur me ketë e leftë ndërsa kur e kam vërejtur G. ka ikur ne drejtim te furrës, ndërsa te dëmtuarin D. R . nuk e kam goditur pasi qe i njëjti ka qene ne anën e kundër te rrugës. Djemtë e mije E. dhe E. nuk kane pasur kurrëgjë ne dorë ndërsa djali E. fare nuk ka qene ne vendin e ngjarjes pasi qe i njëjti në atë kohe ka qene ne punë ne Vojvodinë dhe se natën kritike ka n dëgjuar disa te shtëna më armë zjarri nuk ka vërejtur se kush ka shtëne me armë. Gjatë bastisjes se shtëpisë para kontrollimit djali im E.e ka dorëzuar kallashin për te cilin unë nuk kam pasur dijeni qe kemi pasur ne shtëpi. Natën kritike kur na është bastisur shtëpia djali im E. ka qene te miqtë e vetë dhe unë përket kam marrë vesh me vonë, pasi qe i njëjti ka qene ne Vojvodinë e atë natë para natës kritike ne mëngjes ka ardhur në shtëpi, por unë përket nuk kam ditur dhe përket kam marrë vesh pas dy jave kur kam pasur vizitë ne burg jam njoftuar se djali se bashku me bashkëshorten ka shkuar jashtë Kosove. Ka mohuar qe i ka mëshuar D.apo dikujt tjetër përpos N.

I akuzuari **E. R.** ne mbrojtje te vetë ka deklaruar se natën kritike ai se bashku me vëllain E. kam dalur ne qytet me pije kafe diku rreth orës 21:30 min, dhe rrugës duke ecur e cila është rrugë e ngushte aty pari ka kaluar një automjet nga drejtimi i kundërt dhe përmes dritares së atij automjetit këtu i dëmtuari F. e ka qitur kokën jashtë dhe na ka shajtur “ ja q... nënën “ ai ka qene ne ulësen e prapme unë me vëllai kemi vazhduar rrugën kemi hyre ne një dyqan për te blere disa zhiletë e pas kësaj kemi shkuar ne një kafiq kemi pije kafe atë dite kemi qëndruar 10 – 15 min, dhe jemi nisur ne drejtim te shtëpisë, dhe gjate rrugës prape jemi takuar me G. dhe me aty dy djemtë te tjerë te cilët ishin duke qëndruar afër automjetit te ndalur ne rrugë. Duke kaluar aty afër na është drejtuar G. prape me shamje te njëjtë, pse me nxunë rrugën, dhe me një moment G. me ka ra shuplake ne faqe dhe menjëherë kemi filluar me përleshje jemi rrahur me grusht, dhe nga mbrapa N. me ka ra. Në ndër kohe e kam vërejtur babën tim G. duke ardhur ne vendin e ngjarjes i cili ishte ne rroba te punës dhe i njëjti ka filluar t e na bërtas qe te shkojmë ne shtëpi. Unë menjëherë jam larguar prej aty kam shkuar për në shtëpi ndërsa E. ka vazhduar te qëndroi aty se bashku me babën, e ne ndërkohe të njëjti kane ardhur ne shtëpi ku me vone kane ardhur polici se ne pyetjen e tyre se a keni diçka ilegale unë kam dorëzuar kallashin. Këtë kallash unë se bashku me vëllai E. e kam blerë ne tregun e Gjakovës ne lamën e druve nga një person nga Shqipëria. Vëllai im E. nuk ka qene në shtëpi, i cili ka qene përkohësisht i punësuar ne një furrë ne Serbi. Ne pyetje te Gjykatës se ne Prokurori keni deklaruar se ju kur keni shkuar ne shtëpi kemi marrë kallashin keni ardhur ne vendin e ngjarjes dhe keni shtëne ne ajër me kallash, i njëjti ka deklaruar se po ashtu ka deklaruar, por këtë e ka bere nga se ka qene i frikësuar ne mënyre qe ti ndihmoi babës dhe vëlla, dhe

ka qene veç sa i ka mbushur 18 vjeç dhe kam dashur me marrë përgjegjësinë unë. Është e vërtete qe i kam mëshuar D.me boks, por goditjet kane qene te ndërsjellat.

I akuzuari **E. R.** ne mbrojtje te vete ka deklaruar: se me dt. 01.09.2013, ai se bashku me vëllai e tij E. ka dalur ne qytet aty rreth orës 22:30 min, dhe rrugës nga drejtimi i kundër ka ardhur një automjet i cili ka kaluar pranë nesh dhe njeri prej personave qe ka qene ne automjet e ka qel dritaren e automjetit i cili ka qene ne pjesën e prapme e ka qitur kokën jashtë dhe na ka shajte me nënë duke na thënë qe te lëshojmë rrugën nga se rruga ka qene një kahesh dhe e ngushte, te njëjtit kane vazhduar dhe unë se bashku me vëllai. Pasi qe kemi blere disa gjera ne supermarket dhe kemi pire kafe pas 15 minuta jemi kthyer për ne shtëpi dhe prape kemi vërejtur se ai automjet i cili me herët ka kaluar pranë nesh ishte i ndalur skaj rrugës ku ishin 3 persona kishin qene duke pire birra, dhe sigurisht kane qene duke na pritur. Ne tu afruar tek ata djem dhe njeri prej tyre tha se a kenë këta djem, qe na n xanën rrugën e na shajten nënën, në këtë moment D.tha po këta vet janë, dhe pas këtyre fjalëve D. R., se bashku me G. kane mësyre ne drejtim te vëllai për te goditur me grushte dhe me shqelma. Unë jam afruar te N. duke i thënë se te njoh dhe nuk kam dëshirë qe te përlehemi dhe i njëjti menjëherë me ka goditur me boks ne fytyrë dhe ne ndërkohe me është ofruar D. me ka rrokur për xhokës dhe me ka mbështetur për muri, e me pas jemi perla te gjithë ne mes veti me shkelma dhe grusht. Në ndërkohe ka ardhur baba ime G. i cili ka pasur ne dorë një leftë druri, dhe unë gjatë përleshjes jam rrezua për toke me goditje, goditjet qe i kam marrë nga N. Z. dhe pas kësaj unë kam shkuar ne shtëpi e kam marrë kallashin dhe kam ardhur ne vendin e ngjarjes dhe N.i kam thënë qe te rruhet, e D. R. me ka mësyre për te me marrë armen e kam shtyje e kam raportuar armën dhe kam shtënë për toke dhe kam pare qe D. është rrezua për tokë. Sa i përket vëllait te tij E. i njëjti fare nuk ka qene ne vendin e ngjarjes nga se ai ka punuar ne Vojvodinë, mirëpo ai atë dite kishte ardhur ne vizitë .I njëjti nuk ka lidhje me këtë rast dhe se plagosja e D. e kam bërë unë, edhe pse në Prokurori vëllai im E. ka deklaruar qe ai ka gjuajtur me armë. Arma ka qene personalisht e imja, e kam blere ne tregun e Gjakovës nga një person nga Shqipëria dhe kurrkush nga anëtarët nuk ka ditur për te, dhe se armën natën kritike e ka dorëzuar vëllai im i vogël E. , pa na bastisur policia. Unë për vëllai E. kam kuptuar qe ka dalur jashtë Kosove pasi qe kam dalur nga burgu.

I akuzuari **E. R.** ne mbrojtje te vete deklaroi: se jeton ne bashkësi familjare 2 prindër, bashkëshorten dhe dy vëllezër, dhe se e njeh vetëm te dëmtuarin D. R. , pasi qe është afër shtëpisë së tij. Ka deklaruar se ditën kritike me dt. 01.09.2013, se bashku me bashkëshorten dhe fëmijët ka qene ne fshatin ... K- Deçan te miqtë, dhe se ne shtëpi është kthyer rreth orës 22:00/h, kur ka shkuar ne shtëpi nuk i ka takuar anëtarët e familjes babën dhe vëllezërit dhe nga nena është njoftuar se te njëjtit janë arrestuar për shkak te përklarjes qe ka ndodhur. Te nesërmen jam larguar nga shtëpia kam shkuar për ne Suedi për mes rrugëve ilegale dhe ne Suedi kam qëndruar deri ne muajin tetor te viti 2018, për arsye se nuk kam pasur dokumentacionin e rregulluar dhe te njëjtit me kane kthyer ne Kosovë dhe posa kam mbërrir ne aeroportin e Prishtinës aty menjëherë jam arrestuar dhe me kane dërguar ne vuajtje te dënimit qe kam qene i gjykuar ne 3 (tri) vite e gjysme, për një grabitje me armë qe jam gjykuar nga Gjykata e Qarkut ne Prizren. E me vone kam kuptuar qe kam qene i dyshuar edhe për këtë rast i përklarjes. Ne pyetje te Prokurorit ne deklaratën e dhënë ne prokurori me dt. 01.11.2018, se i dëmtuari D. R. ka deklaruar se e ka vërejtur me ka ardhur ne drejtim te tyre E., E. dhe G. , dhe kam vërejtur s e këtu E. ka filluar me kallash qe te gjuaj përpyetë dhe atë nga lartësia rreth 1 m, prej tyre dhe se ju keni drejtuar tytën e kallashit ai ka ndërhyre dhe ju ka thënë qe te largoni tytën e me pas E. me ka thënë qe te ulen ne dy gjunjë mbështetur për tokë dhe ai nuk ka dashur te ulet dhe se ju pas kësaj keni

filluar me gjuajtur afër këmbeve nga lartësia 1 m, dhe prej këtyre te shtënave e keni qëlluar ne zogun e këmbës, i njëjti i ka mohuar këto thëniet e tija. Por ka thënë ka kuptuar se këto te shtëna i ka bere vëllai i tij i vogël E.. Ne pyetjen e Kryetarit të Trupit Gjykuese se kur keni shkuar ne Vojvodinë i njëjti ka deklaruar se ka shkuar pas rastit kritik disa dite dhe atë pas një jave. Dhe se këtë një jave ka ndenjur ne shtëpi te halla nga se e ka kërkuar policia. Dhe ne pyetje tjetër te Kryetarit të Trupit Gjykuese se kur keni qene herën e fundit ne Vojvodinë para ditës kritike i njëjti ka deklaruar se para 5 – 6 muajve para rastit. Ka mohuar se ka qene ne vendin e ngjarjes duke u mbrojtur se ka qene natën kritike te miqtë e vete, po ashtu ka mohuar se arma ka qene e tij, andaj ka propozuar Trupit Gjykuese qe te liroi nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit **G. R. av. A. R.** ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se aktakuza ndaj te mbrojturit te tij te hudhet poshtë si e pa bazuar dhe te bihet aktgjykim lirues nga se nga provat e administruara nga mbrojtja e te mbrojturit tim te dhënë ne të gjitha fazat e procedurës ne mënyrë te pa kontestuar është vërtetuar se i mbrojturi im nuk është kryes i kësaj vepre penale dhe se aktakuza bazohet vetëm ne supozime duke mos mbështetur asnjë provë materiale dhe e njëjta bazohet vetëm ne deklarata e te dëmtuarve. Dhe tani e mbështes Prokurorinë e çështjes pasi qe ndaj e mbrojturit tim ka hequr dore nga ndjekja penale për dispozitivin II te akuzës për lëndime te renda trupore ne bashke kryerje, ndërsa sa i përket veprës penale te lëndime te lehte trupore ne bashke kryerje kërkoi nga Trupi Gjykuese qe te lirohet nga akuza nga se i njëjti nuk ka ndërmarr asnjë veprim të kundër ligjshëm i njëjti ka qene ne vendin e ngjarjes me qellim te qetësisimit dhe se i njëjti edhe pas ngjarjes ka ndikuar pozitivisht qe te arrihet pajtimi ne mes te palës së dëmtuar dhe familjes se tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit **E. R. av. M. V.,** ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se : unë nga Prokurori i Çështjes kam pritur qe i njëjti te heqe dore nga i akuzuarit E. R. ne mungesë te fakteve dhe provave ne te cilën është ngritur akuza ndaj tije. I njëjti ne mbrojtjen e vete te dhënë tek Prokurori i Çështjes me dt. 01.11.2018, ne prezencën time si mbrojtës i cili ka deklaruar se natën kritike me familjen e ngushte te tij ka qene ne vizitë te miqtë e tij ne fshatin ... K- Deçan dhe aty ka qëndruar deri ne ora 22:00 dhe kur është kthyer ne shtëpi ka parë që nuk janë ne shtëpi baba i tij dhe vëllezërit e tij, qe i ka marrë policia. Ne seancën e dt. 25.04.2019, ne mbrojtjen e vete i akuzuari E. R. ka deklaruar se natën kritike gjate kacafytjes me te dëmtuarit nuk ka qene prezent E. R., por aty ka qene vetëm baba i tij G.dhe vëllai E. . Dhe se i njëjti ka deklaruar se armen automatike personalisht e ka blere vete nga një person nga R. e Shqipërisë, te cilën armë e ka fshehur ne shtëpi dhe natën kritike pas përleshjes i njëjti është kthyer ne shtëpi e ka marrë armën është kthyer ne vendin e ngjarjes dhe me këtë armë ka shtënë ne ajër dhe ne drejtim te dëmtuarit D. R. , duke gjuajtur ne toke, me ç rast është plagosur nga gjuajtjet . Gjate bastisjes se shtëpisë dhe ne pyetje te zyrtareve policore a keni diçka te ndaluar te jashtë ligjshme dhe këtu i akuzuari Erblin e ka dorëzuar armën. Dhe këtu i akuzuari E. ka deklaruar se arma ka qene e tij personale dhe se natën kritike ai e ka plagosur D. R. . Aktakuza është ngritur vetëm me deklaratën e dhënë nga pala e dëmtuar andaj Gjykata nuk mund te bazoi Gjykimin vetëm me këtë deklaratë nga se këtu i mbrojturi im mohon kryerjen e kësaj vepre penale dhe i propozoi Trupit Gjykuese qe ndaj te mbrojturit tim te merret aktgjykim lirues.

Gjykata ka administruar provat e propozuar ne aktakuzë duke i marrë ne pyetje ne cilësinë e dëshmitareve këtu te dëmtuarit D. R., G.B.dhe N. Z. .

Dëshmitari - i dëmtuari **D. R.**, ne deklaratën e dhënë ne polici, prokurori dhe ne seancën e shqyrtimit gjyqësore ka deklaruar se : me dt. 01.09.2013, ka qene ne punë ku ka punuar tek pronari N.Z. dhe se bashku me pronarin me kolegen e tij t e punës G. B. me automjetin e N. jemi nisur qe te shkojmë për ne shtëpie dhe kur kane ardhur ne rrugën e W. e cila rrugë është e ngushte ka qene i ulur ne ulësen e përparme t e automjetit e te cilën automjet e ka drejtuar N. dhe kur kane ardhur afër shtëpisë se tij kane dalur ne automjeti qe te përshëndeten ne ndërkohe kane ardhur këtu te pandehurit E.dhe E. R. dhe na janë drejtuar se pse na keni shajtë. Unë këta i kam njohur nga se i kam ne Lagje dhe i luta qe te ecin te mos bëjnë probleme dhe ne këtë moment E. i ka ra ne koke G. dhe aty ka filluar përleshja ne mes këtyre dyve, dhe N. dhe unë jemi mundur ti ndajmë dhe këta kane vazhduar për ne shtëpi, dhe skane kaluar 3 – 4 minuta te njëjtit janë kthyer se bashku me babën e tyre G. i cili ka pasur ne dorë një shkop bejzbollit ndërsa vëllai tjetër i tyre E. ka qene me pushke automatike, ndërsa E. ka qene me armë, ka pasur revole, dhe ne fillim më është drejtuar .E. direkt me tyte te kallashit dhe nga unë kërkoj kë qe t e ulem ne dy gjunjë dhe pastaj me ka ra ne koke ne ballë. Në atë moment G. me shkop bejzbollit pasi qe jam plagosur nga E.me ka ra dy here apo tri here, duke me shëmuar ne këmbë dhe ne këtë moment më është thyer këmba complete ka mbetur vetëm ne lëkurë, me q rast jam ra ne toke dhe tani me janë vërsulur me goditje Er. dhe E. duke mëshuar me boksa dhe shkelma, dhe pas kësaj janë larguar nga vendi i ngjarjes ndërsa N. me ka marrë dhe ma qar ne Emergjence ne Gjakovë. Unë në Spital jam nënshtruar operacionit nga se kam pasur plumbë ne këmbë dhe me operacion me është nxjerre plumbi. Dhe ne këmbë është vendosur pjesa e metalit shipk, dhe pas kësaj kam pasur edhe dy operacioni, me q rast 7 muaj nuk kam mundur te eci dhe tani kam dhimbje kohe pas kohe, kur ndryshon koha dhe nuk jam me për pune te renda nga se nuk mund te qëndroi gjate ne këmbë. Plagën e armës së zjarrit e kam marrë nga E. dhe se i njëjti ne fillim tytën e kallashit me ka drejtuar ne xhokës, duke kërkuar qe unë te ulen ne dy gjunjë te njëjtit ti përkulen, unë nuk kam dashur te beje këtë dhe i njëjti ka shtënë ne kallash rafal ne drejtim te këmbëve dhe njeri nga plumbat me ka kapur ne këmbë dhe q rast jam plagosur.

Të njëjti kane dërguar burra qe te pajtohem por unë nuk kam pranuar, dhe se para rastit kritike me këtu te pandehurit kurrë nuk kam pasur probleme, problemi është krijuar natën kritike, dhe se kur kemi kaluar me automjet rruga ka qene e ngushte pa ndriçime dhe këtu janë shajtur ne mes veti G.B. me E. .

Dëshmitari - i dëmtuari **G. B.** ka deklaruar se : këtu te pandehurit G., E., E. dhe E.R. me herët nuk i ka njohur, ndërsa te dëmtuarit N. dhe D. i ka njohur nga se kane punuar ne lokal in e N., dhe se natën kritike me dt. 01.09.2013, diku rreth orës 22:00 pasi qe e kemi përgatitur lokal in për punë i cili lokal gjendet ne afërsi te shkollës se mesme, dhe me automjetin e pronarit N. “ ... “ jemi nisur qe te dërgojmë D. për ne shtëpi. Automjetin e ka drejtuar N. ne ulësen e përparme ka qene D. dërsa ai ka qene ne ulësen e mbrapsmë, dhe kur kane ardhur ne lagjen “ . “ ne rrugën “ ... “ aty pari kane kaluar dy person duke ecur ne këmbë dhe njërin prej tyre e dëgjova kur na shajti me nënën duke na thënë “ se po shkoni ne p. te samës” dhe te dëgjuar unë i thash N. dhe D.se njeri prej atyre personave na shajten, mirëpo ne e vazhduam rrugën, dhe unë nuk dije arsyen pse na shajten, dhe se aty rruga është shumë e ngushtë mund te kaloj vetëm një automjete është një drejtimesh. Kur kemi ardhur afër dyerve te shtëpisë së D., N. e ka ndalur automjetin dhe kemi dalur q e te përshëndetemi me D. dhe D. ka hyre ne një dyqan ka blere dy birra ndërsa unë i kam thënë se nuk dua kurrëgjë, derisa ishin duke qëndruar aty erdhën aty dy djemtë dhe u afruan aty. N. ju drejtua atyre dhe ju tha se çka ka te re, e ata u përgjigjen se ju na shajtet nënën, dhe lutem qe te vazhdojnë rrugën dhe njeri prej tyre

dy djemve më është afruar dhe me ka goditur me kokën e tij ne kokën time. Unë fillova te largoi duke e shtyrë dhe ne këtë moment ka ndërhyre dhe personi tjetër vëllai i tij, dhe aty filloi një rrahje ne mes meje dhe atyre dyve, me ç rast është kyçur edhe N. me na nda dhe pas kësaj jemi goditur edhe me grusht. Ne ndërkohe ka ndërhyre edhe D. dhe disa kalimtar te rastit dhe na kane nda. Ata dy vëllezër kane vazhduar rrugën për ne shtëpi dhe ne kemi qete aty ende dhe pas dy - tre minuta kane ardhur 3 persona, dhe ne mesin e tyre nuk ka qene ai person qe me herët është përlarë me neve. Njeri ka qene i moshuar dhe sa me duket ka qene baba i tyre, dhe i njëjti ka pasur ne dore një shkop bejsbolli, gjersa tjetri ka pasur një kallash ne dorë, dhe i cili ka qene me shtate me i rritur se te tjerët dhe nuk ka qene herën e pare ne vendin e ngjarjes i njëjti ka filluar me te shtëna me kallash duke gjuajtur ne ajër, dhe na është afruar dhe i ka bere dhe dy shtëna tjera ne drejtim te tokës asfaltit afër këmbeve tona. D. ka qene para nesh dhe te shtënat janë bere afër këmbeve te tija. D. i është drejtuar këtij personi se pse po shtynë me kallash e ky person i është drejtuar D. dhe i tha te ulet ne dy gjunjë për toke. D. nuk është ulur dhe pas kësaj ky ka shtëne prape me kallash ne drejtim te tokës afër këmbeve te D. dhe njëra prej te shtënave e ka rrokur ne këmbë, pas këtij momenti i njëjti ja ka drejtuar kallashin N. dhe N. ka thënë gjuaj por ky i tha se po te fali. Ne atë moment N. është goditur me shkop bejsbolli ne pjesën e prapme t e kokës nga ky njeri i moshuar. Po ashtu edhe unë jam goditur nga ky i moshuar dhe atë një here ne dorën e majtë me q rast jam mbrojtur qe te mos me godas ne kokë. Ndërsa ky personi i riu me ka goditur ne shpindë. Dhe pas kësaj unë kam filluar te largohem prej aty kam shkuar teposhtë . Pastaj aty janë grumbulluar qytetar te kalimtar te rastit e kanë marrë D.e kemi vendosur ne automjetin e N. dhe e kemi dërguar ne spital, ndërsa unë me N. kemi dhënë deklaratë ne polici. Me vone kanë ndërhyre burrat dhe unë rastin jau kam falur.

Dëshmitari - i dëmtuari **N. Z.** ka deklaruar se : me dt. 01.09.2013, ka pasur lokalin afër shkollës se mesme dhe i ka pasur te punësuar dy punëtor dhe a të G.B. dhe D. R.Pasi qe me 1 shtator fillon mësimi unë me punëtoret e kam përgatitur lokalin për punë dhe pasi e kemi kryer punën unë me automjetin tim te markës “ .. “ se bashku me G. dhe D. jemi nisur qe te qojmë D. për ne shtëpi. D. ka qene i ulur ne ulësen e përparme ndërsa G.ka qene ne ulësen e pasme, dhe rrugës kur kemi kaluar ka qene rrugë e ngushtë i kam pare dy persona qe kane ecur, dhe G. me ka thënë se këta dy persona na shajten dhe na banën me dore. Unë nuk e ndala automjetin vazhdova dhe kur erdhëm te shtëpia e D. kemi dalur qe te tre nga automjeti dhe ne një shitore aty afër kemi marrë qe te tre nga një birre, dhe aty te hyrja e dyqanit filluam ti pimë ato birra dhe për pak qastesh ata dy djemtë qe kane qene rrugës e qe Gr. na tha qe na shajten dhe njeri prej tyre ju afruar G. , dhe i tha se perse na shajte e ai u përgjigje se çka ka lidhje pse ju shajtëm. Unë ndërhyra dhe njëri prej tyre na tha se nuk kemi kurrjë me ty, dhe unë ju thashë se ata janë punëtoret e mije. Pas këtij momenti njeri prej tyre e sulmoi G. duke e goditur ne kokë me kokën e tij, dhe kane filluar te përlahen me grusht dhe shqelma dhe nga shitorja kane dalurë disa persona tjetër kane ndërhyre dhe na kane nda. Ne kemi vazhduar te qëndrojmë aty dhe unë e kam vetur D. se a i njehe këta persona, dhe me tregoi se janë te lagjes se tij dhe me ka treguar se me herët kurrë nuk ka pasur probleme. Nuk kane kaluar as 5 minuta, dhe tani kane ardhur 3 persona, njeri ka qene me kallash me dore i cili ka qene me shtate me te larte, i cili nuk ka qene ne rastin e parë te përlarjes, tjetri ka qene i moshuar e q e me vone kam kuptuar se ka qene baba i tyre dhe tjetri ka qene i riu i cili me herët kishte qene pjese marrë ne rrahje dhe ky ka pasur një revole ne dorë, ndërsa baba i tyre ka pasur një shkop bejsbollit. Ne momentin kur janë afruar këta persona, dhe ky djalë qe ishte me kallash ka filluar me të shtëna ne drejtim te këmbeve te mija dhe D. ndërsa G. ka qene me larg. Te shtënat i ka bere me ndërprerje njeri pas tjetrit, ashtu qe unë

kam ndërhyre ja kam shtyrë me dore kallashin për te ja nderuar drejtimin, dhe ne këtë moment ky njeri i moshuar ka goditur prapa kokës me shkop, gjersa ky djali tjetër qe ishte me revole ka shtënë ne drejtim e këmbeve te mija, por nuk me ka qëlluar dhe i njëjti ka shtënë vetëm një here. Ky i moshuar ka goditur ne pjesën e prapme te trupit ne shpinë ne anën e djathte ne q rast me ka shkakuar lëndime ne shpinë, dhe unë tani kam filluar t e largohem nga vendi i ngjarjes dhe ne atë qastë kam dëgjuar disa te shtëna ne drejtim te D.. Dhe kam kërkuar nga D. qe edhe ai te largohet. Ne ikje e sipër duke u larguar nga vendi i ngjarjes D.e ka lëshuar forca dhe është shtrire ne asfalt dhe tani kam vërejtur se ka pasur lëndime ne këmbën e djathte ne pjesën e nen gjurit, dhe këto lëndime i ka marrë nga te shtënat nga ky personi me kallash. Pas këtyre qasëtëve ata janë larguar nga vendi i ngjarjes dhe unë e kam marrë D. dhe me automjetin tim e kam dërguar ne Spital. Dhe se ne këtë rast kemi pasur lëndime unë dhe G.dhe D. ka qene me rende i lënduar. Ne spital personeli i spitalit ka lajmëruar policinë dhe unë pas kësaj kam dhënë deklaratë. Në ndërkohe kane ndërhyrë burrat dhe unë te njëjtëve rastin javë kam falur.

Gjykata ka lexuar prova materiale ka lexuar raportin e oficerit policor A. D. me numër 2013-OP-1192 dt. 02.09.2013, ka bere leximin e vërtetimit te armëve te konfiskuara me numër te njëjte dhe datë te njëjtë ka bërë leximin e raportit te shpejtë me numër te njëjtë te dt. 01.01.2013, ka bërë leximin e listës së dëshmimeve te përpiluara nga Njësi i Forenzikës pranë Njësisë se Hetimeve ne Gjakovë, me numër te njëjtë te dt. 01.01.2013, ka bërë leximin e raportit te ekspertizës se ekspertit mjeko - ligjore për te dëmtuarit D. R., N. Z., dhe G. B., i përpiluar nga eksperti mjeko - ligjore dr. F. B., te dt. 07.07.2014, si dhe ekspertizën plotësuese po nga i njëjti ekspert mjeko - ligjore dt. 02.04.2019, si dhe ka bërë leximin e raporteve mjekësore t e përpiluar nga reparti i emergjencës i Spitalit Regjional “ Isa Grezda “ në Gjakovë, te dt. 01.09.2013, ka bere leximin e flete lëshimit me epi krizë për te dëmtuarin D. R., te lëshuar nga Spitali Regjional “ Isa Grezda “ ne Gjakove, reparti i ortopedisë, si dhe ka bere leximin e raportit te këqyrjes se vendit te ngjarjes i përpiluar nga i njëjti njësit me numër te njëjtë te dt. 01.09.2013, si dhe ka bere shikimin e fotove t e vendit te ngjarjes.

Gjykata pas administrimit te provave te propozuara ne aktakuze, mbrojtjes se t e akuzuarve te njëjtat i vlerësoi me vëmendje një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën dhe si rezultat i besimeve te tyre vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se t e akuzuarit G. R., E. Ro. dhe E. R. natën kritike me 01.09.2013, pas një mosmarrëveshje me këtu te dëmtuarit e akuzuarit E.R. dhe E. Rogova natën kritike rreth orës 22:40 min, ne rrugën e “ W. “ tek vendi ku lidhet rruga “ E. Gj. “ pas një sharje ne momentin e të dëmtuarit ishin duke kaluar ne automjet dhe para shtëpisë së të dëmtuarit D. R. këtu te pandehurit E. dhe E. ne fillim janë fjalosur me te dëmtuarin G. kane filluar te përllahen me grushte ku i shkakton lëndime te lehta trupore te dëmtuarve G.B.dhe D.R., ku lëndime pëson edhe i pandehuri E. R. te njëjtit kthehen ne shtëpi, dhe informojnë prindin G. R. për rrahje qe ka ndodhur ne mes tyre, dhe te dëmtuarve kështu qe i akuzuari G. merr ne dore një mjetë te përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve leftë ndërsa i pandehuri E. R. merr automatikun kallashin dhe tani kthehen ne vendin e ngjarjes G. R., E.R. dhe E. R. dhe i gjejnë këtu te dëmtuarit D. R., G. B. dhe N. Z. dhe këtu i akuzuari E.R. ka filluar me te shtëna ne ajër me kallash dhe i është afruar këtu te dëmtuarve dhe nga i dëmtuari D.R. ka kërkuar qe te ulet ne dy gjunjë për toke, D. nuk ka pranuar dhe pastaj ka shtënë me kallash ne drejtim te tokës ne afërsi te këmbeve te D. dhe nga këto te shtëna njeri prej plumbave e ka rrokur ne këmbën me q rast të njëjtit i shkakton lëndim te

rëndë trupor. Po ashtu këtu të akuzuarit G. R. , E. R. i shkaktojnë lende te lehta trupore këtu te dëmtuarve D.R. F. B.dhe N. Z. lëndime këto te përshkruar me afër ne mëndin e ekspertit mjeko – ligjore dr. F. B.

Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëshmitë e te dëmtuarve qe janë marrë ne pyetje ne cilësinë e dëshmitareve e cilët në mënyrë bindëse kane shpjeguar gjithë rrjedhën e ngjarjes qe ne fillim qe përklarja ka ndodhur ne mes vëllezërve E. dhe E. R.a ne një rënë anë dhe te dëmtuarit G. B. ku te njëjtë janë rrahur me grushte dhe me shkelma dhe pas kësaj ne vendin e ngjarjes janë kthyer mbas 5 minuta te pandehurit G., E. dhe E. R., ku E. është kthyer me kallash ne fillim ka gjuajtur ne ajër e pasi qe i dëmtuari D. nuk i është bindur urdhrave te tija qe të përkulet dhe te bien ne te dy gjunjët ne tokë, ndaj e njëjtë ka shkrepur me pushkë ne tokë afër këmbeve te tija, ku njeri prej plumbave i ka shkaktuar lëndime me armë zjarri e kjo është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit mjeko - ligjore ku ne këtë ekspertize ka cekur se plagët e shkaktuar D. R. , janë shkaktuar nga arma e zjarrit ne regjionin e kërcellit te djathte, thyerje e kërcellit te djathte , trupi i huaj metalik dhe nxjerrja e tij kirurgji kishte . Po ashtu eksperti mjeko – ligjor ne mendimin plotësues te dhënë ne seancën e shqyrtimit ne forme te shkruar me dt. 02.04.2019, ne mendimin përfundimtar ka cekur se lëndimet e sipër përmendura bëjnë pjese ne dëmtime te renda trupore dhe kjo plage është shkaktuar nga predha e hedhur nga arma e zjarrit. Ndërsa te dëmtuarit N. Z. ka pasur lëndime ndrydhja e indeve te buta ne regjionin e qafës dhe regjionit te shpatullës se djathte te shoqëruara me gërvishtje te shkaktuar me mjete te forte mbrehte e qe te tilla bëjnë pjese ne dëmtime te lehta trupore, ndërsa i dëmtuari G. B. ka pasur dëmtime ndrydhje e indeve te buta te regjionit iJOR dhe gërvishtje mbi vetullën e majte dhe ne parakrahun e majtë te shkaktuar me veprim mekanik te mjetit te forte mbrehte e qe janë dëmtime te lehta trupore.

Gjykata ka hedhur poshtë mbrojtjen e te akuzuarit E. R. i cili ne seancën e shqyrtimit kryesore ka deklaruar se ai pas konfliktit te parë mosmarrëveshjen qe ka pasur me G. B. , dhe rrahjes me te, ka shkuar ne shtëpi ka marrë kallashin ai i ka shkaktuar lëndime te rënda trupore këtu te dëmtuarit d. R., duke e marrë përgjegjësinë mbi veti, nga se mbrojtja e tij është ne kundërshtim edhe ne mbrojtjen e te akuzuarit E. R. i cili te Prokurori i Çështjes ka deklaruar se kallashi ka qene i tij, dhe ai te njëjtën e ka përdor natën kritike, andaj Gjykata ketë mbrojtje te akuzuarit E. R. e ka hedhur poshtë si te pa bazuar nga se është ne kundërshtim me deklarimin e të dëmtuarve - dëshmitareve te cilët ne mënyrë te kjart qe te tret kane deklaruar se pas mos marrëveshjes përklarjes se te akuzuarve E. dhe E. R. dhe te dëmtuarit Gr. B., pas 5 minuta ne vendin e ngjarjes janë kthyer i akuzuari G.R. me një leftë ne dore ndërsa i akuzuari E. R. me kallash në dorë dhe të njëjtin kallash e ka përdore ka shkrepur ne ajër si dhe afër këmbeve t e te dëmtuarit D. R. i, me ç rast i ka shkaktuar lëndime trupore me afër te përshkruara ne mendimin e ekspertit mjeko- ligjore dr. F. B.

Po ashtu Gjykata ka hedhur poshtë mbrojtjen e të akuzuarit E. R. i cili ka mohuar se ka qene ne vendin e ngjarjes duke u thirrur në alibi se i njëjti natën kritike ka qene te miqtë e vete ne fshatin ... K- Deçan se bashku me bashkëshorten dhe fëmijët, nga se mbrojtjen e tij është ne kundërshtim me deklarimin e të dëmtuarve veçanërisht deklaratën e dëshmitarit D.R. , i cili këtu te akuzuarin E. R. e ka njohur edhe para rastit kritik nga se shtëpitë i kane shume afër njeri tjetrit dhe deklarimi i tij ka qene bindes për trupin Gjykuese pasi qe i njëjti ne mënyrë te kjart e ka shpjeguar rrjedhën se si është zhvilluar ngjarja kritike kush çka ka ndërmarrë dhe në mënyrë detale ka përshkruar veprimet e këtu te akuzuarit E. kur i dëmtuari D. nuk ka pranuar urdhrin e tij qe te gjunjëzohet te bijën ne

gjunjë ne te dy gjunjët ne atë momenti i njëjti ka gjuajtur ne drejtim te këmbeve te tija. Po ashtu këto thëniet janë vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitareve G. B. dhe N. Z.

Po ashtu Gjykata ka hedhur poshtë tezet e te akuzuarit E.R. i cili ka deklaruar se nuk ka qene ne vendin e ngjarjes dhe se pas natës kritike një javë ka ndjetur te halla dhe pas kësaj ne mënyrë ilegale është larguar nga Kosova. Dhe i njëjti është arrestuar pasi qe është dëbuar nga Suedia është arrestuar ne aeroportin e Prishtinës dhe menjëherë është dërguar ne vuajtje te dënimit sipas aktgjykimit ish Gjykatës së Qarkut ne Prizren.

Ne pyetje te parashtruar nga Trupi Gjykuese se kur ka qene herën e fundit ne pune te përkohshme ne Vojvodinë – Suboticë i njëjti ka deklaruar se ka qene për afërsisht 5 – 6 muaj para rastit. Dhe arsyeja e ikjes ka qene kur ka kuptuar se është duke u kërkuar nga policia andaj ka ikur.

Vërtetimi i kësaj gjendje faktike Gjykata e ka mbështetur edhe ne ekspertizën e ekspertit mjeko - ligjore si dhe dëshmitë e gjetur ne vendin e ngjarjes raporti i shikimit te vendit te ngjarjes foto te vendit te ngjarjes, dhe te gjitha materialet tjera provuese te cilat janë administruar si prova gjate shqyrtimit gjyqësor.

Andaj Gjykata plotësisht dhe përtej dyshimit te bazuar ka vërtetuar gjendjen faktike se ne dispozitivat e këtij aktgjykimi te dhëne ne veprimet e të akuzuarve G.R., E.R. dhe E. R. formohen te gjitha elementet qenësore te veprës penale nga neni 188 prg 2 lidhur me prg 1 nen prg 1.4 si bashke kryes lidhur me nenin 31 te KPRK-se, andaj te njëjtit Gjykata i ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimet si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Ndërsa ndaj te akuzuarit E. R. Gjykata ne mbështetje te nënti 3, te Kodit Penale te R. Kosovës 06/L-074 i cili ka hyre ne fuqi ne muajin Prill 2019, ndaj kryesit ka zbatuar Ligjin me te favorshëm andaj i njëjti është shpallur fajtor për veprë penale lëndimi i rendë trupore nga neni 186 prg 3 lidhur me prg 1 te KPRK-se, nga se tani me Kodin e Ri për ketë veprë penale është parapare dënimi me burgim prej 1 deri 8 vite, e jo siç ka qene ne dispozitiv te akuzës lëndim i rendë trupore nga neni 189 prg 5 lidhur me prg 1 te KPRK-se, ku është parapare dënimi jo me pak se 3 vite burgim, andaj Gjykata ka zbatuar ligjin me te favorshëm për te akuzuarin.

Po ashtu Gjykata te akuzuarin E. R. e ka shpallur fajtor edhe për veprë penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armeve nga neni 374 prg 1 te KPRK-se, nga se gjate shqyrtimit gjyqësor ne mënyrë bindëse është vërtetuar se këtu i akuzuari E. Rogova natën kritike me dt. 01.09.2013, pa autorizim ka mbajtur armë dhe municion dhe atë pushke automatike AK-47 dhe i njëjti armën e ka përdorur duke gjuajtur ne ajër dhe afër këmbeve te dëmtuarve e kjo është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitareve - te dëmtuarve . R., G.B.dhe N. Z., qe te trete kane deklaruar se arma e ka përdore këtu i akuzuari Er. R. natën kritike. Andaj Gjykata këtyre dëshmitareve jua ka falur besimin e plote e këtyre dëshmimeve.

Po ashtu Gjykata ka hedhur poshtë tezen e mbrojtës se të akuzuarit E. R. av. M. V., i cili ka deklaruar se i mbrojturi i tij natën kritike ne familjen e tij te ngushtë ka qene te miqtë ne fshatin Lumbardhë K- Deçan, dhe është kthyer rreth orës 22:00/h, mirëpo ne këtë çështje konkrete ngjarja është zhvilluar rreth orës 22:40 min, Po ashtu edhe nga mbrojtja e te akuzuarit G. R. i cili ka deklaruar se djali i tij ka qene ne punë - Vojvodinë

në furrë, dhe se i njëjti është kthyer atë dite në mëngjes është e pa themelte nga se i akuzuari E. në mbrojtje të vetë në pyetje të parashtruar nga Trupi Gjykuësor se kur ka qenë herën e fundit në Vojvodinë i njëjti ka deklaruar se ka qenë 5 – 6 muaj para rastit kritikë.

Gjykata duke i marrë parasysh të gjitha këto faktet të vërtetuara ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit E. R. formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale lëndimi i rëndë trupore nga neni 186 prg 3 lidhur me prg 1 të KPRK-se, si dhe të gjitha elementet qenësore të veprës penale mbajtje në pronësi kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 prg 1 të KPRK-se, dhe këtu të akuzuarit i ka shpallur fajtorë dhe i ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga nenet 73, dhe 74 par 1 KPPK-se, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si rrethane lehtësuese Gjykata ka marrë për bazë për të akuzuarin G. R. është njeri në moshë ndërsa të akuzuarit E. dhe E. R. janë të moshës së re, të njëjtit nuk janë gjykuar me herët rrethanat familjare të dëmtuarit G. B. N. Z. nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale, ndërsa për të akuzuarin E. R. si rrethanë lehtësuese ka marrë parasysh sjelljen korrekte të akuzuarit në Gjykim është mbajtës i familjes i ati i dy fëmijëve, ndërsa si rrethane rënduese ka marrë parasysh se i njëjti ka qenë i gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm Gjykatës së Qarkut në Prizren me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 vite e gjysme, e të cilin dënim është duke e vuajtur dhe duke marrë parasysh rrethanat e përmendura më lartë dënimet e shqiptuar ndaj të akuzuarve janë në harmoni në peshën e veprës penale dhe shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurve andaj me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-se, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimin e tyre, të parandaloi personat tjerë, nga kryerja e vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqërorë për veprën penale ngritjen e moralit dhe forcimit të detyrimit për respektim të ligjit.

Duke u bazuar në nenin 83 par 1 të KPRK-se, Trupi Gjykuësor ka vendosur se dënimet e shqiptuara me burgim e pandehurve të llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

Vendimi mbi konfiskimin e pushkës automatike AK- 47 , një karikator dhe një fishekë, është në pajtim me neni 62 par. 1 pika 2,7 lidhur me nenin 374 par 3 të KPRK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të tre ekspertizave të ekspertit mjeko- ligjorë shumen prej 150 (një qind e pesëdhjete) € në mënyrë solidarë, në emër të paushallit gjyqësorë shumen me nga 100 (një qind)€, bazohet në dispozitat e nenit 450 prg 3 të KPPK-se, ndërsa vendimi mbi pagimin e shumës me nga 50 (pesëdhjete) €, në fondin e viktimave bazohet në dispozitat e nenit 39 prg 3 nën prg 1.1 të Ligjit 05-L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve që kërkesën pasurore -juridike të realizoi në kontest të rregullt civil bazohet në dispozitat e nenit 463 prg 1 pika 1 të KPPK-se.

Nga aresyrat e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 par. 1 të KPPK-se është vendosur në dispozitave të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË , - Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr. 60/18, me dt. 24.05.2019 .**

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese ne afate prej 15 dite, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Numri i lëndës: 2018:066487
Datë: 28.05.2019
Numri i dokumentit: 00333686